



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Porsche Kosova” ShPK, me seli në Graçanicë, të cilin sipas autorizimit të përfaqësues M.Z., menaxher i financave, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.35/22 të datës 22.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës, e datës 28.04.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.35/22 të datës 22.03.2023, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Dhoma e Shkallës së Parë, me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I. të të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit “Porsche Kosova” ShPK me seli në Graçanicë, të cilin sipas autorizimit të përfaqësues M.Z., menaxher i financave. Në pikën II. Anullohet vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.36/2019 i datës 14.03.2019. nën pikën III. Detyrohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Porsche Kosova” ShPK me seli në Graçanicë, t’ia pranoj faturat nr.011224/11, 014120/12, 011093/10, 014163/11 dhe 014137/12, si deklarime pa TVSH për periudhat tatimore 2010, 2011 dhe 2012 si dhe ta liroj të njëjtin edhe nga ndëshkimet 25% për TVSH-në e kalkuluar për këto fatura, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor. Ndërsa nën pikën IV. të dispozitivit, Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimit, në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura ATK, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të; konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozon që të aprovohet ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës si e bazuar, aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe të mbetet në fuqi vendimi kontestues i ATK-së, apo çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me Vendimin nr.36/2019 të datës 14.03.2019, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar ankesën nr.36/2019 e datës 23.06.2018 e tatimpaguesit në riprocedurë “Porsche Kosova” ShPK me NRB: 70496143 si dhe NF: 600162028, me drejtor të përfaqësisë z. F.P., adresa: Magjistrala Prishtinë Shkup-Llapnasellë, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore A.nr.1246/14, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr. 03/L-222, Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”. Në pikën II. Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll për pikat kontestuese konfirmohen si të bazuara. Në pikën III. Procedura e ankesës nuk ndërpre në sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit 03/L-222 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, subjekti ushtron padi në Gjykatën, në procedurë të konfliktit administrativ. Dhoma e Shkallës së Parë, pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 22.03.2023 në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, e anulon vendimin nr.36/2019 të datës 14.03.2019 të Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas konkludimeve ndër të tjera në arsyetim se; Gjykata ka konstatuar se e paditura vendimin kontestues ndonëse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1246/14 datës 06.12.2018, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e Gjykatës, duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së. Gjykata nuk i ka pranuar pretendimet e të paditurës në arsyetimin e vendimit kontestues se faturat e lëshuara nga paditësi të faturuara me 0% TVSH-ë janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 27 dhe 28 të Ligjit nr.03/L-146 për TVSH, për faktin se paditësi i ka paraqitur gjykatës dëshmitë dhe atë: Deklaratat Unike Doganore IM4 të liruara nga detyrimet doganore, si dhe Vërtetimet dhe Certifikatat e Invalidëve të Luftës përmes të cilave dëshmohet se këta personat janë invalid të luftës e të cilët në bazë neni 6 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-054 janë të liruar nga tatimi dhe dogana. Po ashtu, gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës gjenden Shënimet e Jashtme të lëshuara nga Dogana e Kosovës përmes të cilave është konfirmuar se këta persona, respektivisht blerës të veturave janë të liruar nga detyrimet doganore, përfshirë Taksa Doganore, Akciza dhe TVSH-ja. Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i të paditurës se vendimi i kontestuar përmban shkelje thelbësore të ligjeve përkatëse, gjegjësisht Ligjit për Procedurën Administrative, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar. Për gjykatën arsyetimi i të paditurës në vendimin e kontestuar se duhet trajtuar si shitje të tatueshme veturën e cila është në emër të F.P., për shkak se këtu eksportues kemi Porsche Maqedonia, kurse për transaksionin në fjalë kemi faturën e lëshuar nga Porsche

Kosova, është i pa bazuar, kjo për faktin se shitja është bërë nga depoja doganore si import i përkohshëm, ndërsa fatura është deklaruar për qëllime të tatimit në fitim po jo edhe për TVSH e cila nuk paguhet për importe të përkohshëm. Tutje, gjykata ka konstatuar se kjo veturë është shitur nga depoja doganore IM7, në procedurë të Importit të Përkohshëm me IM5, duke u mbështetur po ashtu edhe në garancionin bankar të datës 18.05.2011 në vlerë prej 7,000.00, e në fund është dëshmuar se procedura e importit të përkohshëm është mbyllë me deklaratën unike doganore EX3 R-4298/14.04.2014. Gjykata ka shqyrtuar bazën ligjore dhe ka konstatuar se e paditura pretendimin e vet e ka mbështetur në dispozitat e nenit 27 dhe 28 të ligjit 03/L-146 për TVSH, mirëpo gjykata ka konstatuar se në bazë të dispozitave të nenit 6 paragrafi 2 të ligjit 04/L-056 thuhet se si benificion i veçantë është *“Lirimi nga tatimi dhe dogana për veturat speciale për përdorim personal (një veturë në çdo pesë (5) vjet) si dhe i pajisjes ortopedike janë të drejta të cilat i realizojnë invalidët e UÇK nga grupet I deri në grupin VII në përshtatshmëri me shkalën e paaftësisë të përcaktuar me nenin 10 të këtij ligji”*, nga rrjedh se përmes këtij neni invalidët e luftës janë të liruar nga Tatimi dhe Dogana. Prandaj, Gjykata ka vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 81, par 2, nën par 2.2 të ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të Dhomës së Shkallës së Parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor ka vlerësuar drejtë se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e anuluar vendimin e organit të paditur nr.36/2019 të datës 14.03.2019 të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe e obligon të paditurën ATK, që paditësit *“Porsche Kosova”* ShPK, me seli në Graçanicë, t’ia pranoj faturat nr. 011224/11, 014120/12, 011093/10, 014163/11 dhe 014137/12, si deklarime pa TVSH për periudhat tatimore 2010, 2011 dhe 2012 si dhe ta liroj të njëjtin edhe nga ndëshkimet 25% për TVSH-në e kalkuluar për këto fatura, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

Pretendimet ankimore të paditurës nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Dhoma e Shkallës së Parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8 i LPK-së si dhe shkresave të tjera, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar vet gjendjen faktike, dhe ka vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim

të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore ku pa dyshim vërtetohet se e paditura nuk ka arritur ti mbështes konstatimet e veta se tatimi shtesë i TVSH-së për paditësin ka ardhur si rezultat i lëshimit të faturave për shitjet, e të cilat fatura janë më 0% TVSH, përderisa në anën tjetër paditësi pretendimet e veta për faturat kontestuese i ka argumentuar me prova siç janë Deklaratat Unike Doganore IM4 të liruara nga detyrimet doganore, vërtetimet dhe certifikatat e Invalidëve të Luftës përmes të cilave dëshmohet se personat, blerësit të veturave janë të liruar nga detyrimet doganore, përfshirë Taksat Doganore, Akciza dhe TVSH-ja pasi që janë invalid të luftës dhe në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-054 janë të liruar nga tatimi dhe dogana. Prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se mbi bazën e provave të paraqitura dhe të administruara në procedurë gjyqësore paditësit duhet ti pranohen faturat nr.011224/11, 014120/12, 011093/10, 014163/11 dhe 014137/12, si deklarime pa TVSH për periudhat tatimore 2010, 2011 dhe 2012. Kolegji gjithashtu ka konstatuar se Dhoma e Shkallës së Dytë drejtë ka vepruar kur e detyron të paditurën që ta liroj paditësin nga ndëshkimet 25% për TVSH-në e kalkuluar për këto fatura.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.705/23, me datë 08.05.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami